

fq. 2 Mblidhet Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Moneyval)

VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-gusht 2014 *fq. 3-4*

ZHVILLIME TË TJERA

- » Konferenca e tretë mbi mbikëqyrjen globale të sigurimeve *fq. 4*
- » Konferencë mbi sigurinë e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave *fq. 5*
- » Seminar mbi sistemet e pagesave dhe shlyerjes së letrave me vlerë *fq. 6*

LAJMET NGA RAJONI

- » Bosnje-Hercegovinë » Kroaci » Maqedoni » Serbi *fq. 7-8-9*

STUDIME DHE BOTIME

fq. 10

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Mblidhet Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Moneyval)

Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (*Moneyval*), pranë Këshillit të Evropës zhvilloi në Strasburg më 15-19 shtator 2014, sesionin e 45-të plenar për vlerësimin e masave të marra në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Sekretariati i *Moneyval* raportoi për situatën e demokracisë, të drejtat e njeriut dhe zbatimin e ligjit në Evropë, raport që u mbajt nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

Raporti analitik për progresin e Shqipërisë lidhur me rekomandimet e Grupit të Punës për Veprimtarinë Financiare (*Financial Action Task Force, FAFT*) u zhvillua në datë 17 shtator. Shqipëria kishte paraqitur kërkesë për t'u hequr nga procedura e raportimit të rregullt. Sekretariati i *Moneyval* paraqiti konkluzionet kryesore dhe rekomandimet. Në to u theksua se progresi që ka bërë Shqipëria që prej nëntorit 2010, pas vizitës në vend të këtij Grupi Pune, dhe veprimet pozitive për të përmbushur mangësitë kryesore. Megjithatë, iu propozua seancës plenare që Shqipëria të kryejë raportim edhe në dhjetor 2014, duke e plotësuar me informacion shtesë. Në raport thuhej:

“Që nga vizita në vend, Shqipëria ka zbatuar legjislacion të ri, i cili ka rishikuar kuadrin ligjor në një sërë çështjesh. Ky kuadër ligjor është i ri dhe informacioni lidhur me efektivitetin nuk është bërë i mundur në disa aspekte.

Në përgjithësi këto ndryshime në mënyrë të dukshme përmirësojnë zbatimin nga Shqipëria të kërkesave. Gjithsesi duke parë një numër boshllëqesh në informacionin për praktikën në terren, nuk është arritur akoma niveli i përputhshmërisë LC (e përputhur tërësisht)”.

Më pas u kaluan me radhë raportet nga Bosnje-Hercegovina, Estonia, Gjeorgjia, Lituania, Qipro, Republika Çeke, Rusia, Sllovakia e San Marino.

Në një nga seancat mori pjesë dhe Mbretëresha e Holandës, Maxima, në cilësinë e saj si avokate speciale e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për shërbimet financiare të arritshme. Mbretëresha Maxima nënvizoi rolin që shtetet mund të luajnë në përmirësimin e aksesit në shërbimet financiare. Ajo theksoi se instrumentet ekzistuese ligjore lejojnë shtetet të sigurojnë që lufta kundër pastrimit të parave dhe zhvillimi i shërbimeve financiare për të gjithë shtresat e popullsisë, të plotësojnë njëri-tjetrin.

Në sesionin plenar, u propozua edhe ngritja e një grupi pune për hartimin e ndryshimeve lidhur me rekomandimin Rec.(2005)10 për teknikat speciale të investigimit.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-gusht 2014

Tregu i sigurimeve u rrit me 40.96% gjatë periudhës janar-gusht 2014. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 7.54 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 0.54% krahasuar me të njëjtë periudhë të një viti më parë, duke arritur në 670,489 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto në total, regjistruan një ulje me 0.73% në krahasim me periudhën janar-gusht 2013.

Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.27 miliardë lekë, apo 71.36% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës gjatë periudhës janar-gusht 2014 u rrit me 45.24% krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 4.39 miliardë lekë gjatë periudhës janar-gusht 2014, duke shënuar një rritje prej 80.20% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 58.39% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- » *Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë*, të cilat zunë 14.87% të tregut të Jo-Jetës;
- » *Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme* të cilat së bashku zunë 12.54% të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 10.79% krahasuar me periudhën janar-gusht të vitit 2013. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto, afro 62.60% e sigurimit të Jetës, i përket sigurimit “Jetë debitori”.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-gusht 2014

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



ZHVILLIME TË TJERA

Konferenca e tretë mbi mbikëqyrjen globale të sigurimeve

Në datat 9-10 shtator 2014 në Frankfurt, Gjermani u organizua konferenca e tretë mbi mbikëqyrjen globale të sigurimeve me temë “Mbikëqyrja globale në sigurime - A është koha për një këndvështrim global?”. Konferenca u organizua në bashkëpunim ndërmjet Qendrës Ndërkombëtare për Rregullat në Sigurime (ICIR) pranë Universitetit Goethe, Frankfurt Gjermani, Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), Qendrës për Studime të Rregullave në Sigurime pranë Universitetit St. John, New York dhe Bankës Botërore.

Përfaqësues të rregullatorëve dhe industrisë, si Komisioneri i Sigurimeve të Shtetit të Amerikës, Iowa dhe Presidenti i Shoqatës së Mbikëqyrësve të Sigurimeve të Amerikës Latine, Drejtori Ekzekutiv i EIOPA-s, përfaqësuesi i BB dhe përfaqësues të dy grupeve kryesore në sigurime paraqitën eksperiencat e tyre në lidhje me zbatimin e mbikëqyrjes me bazë risku dhe sfidat e ardhme në procesin e zbatimit të standardeve ndërkombëtare, si edhe çështjet që lidheshin me mbrojtjen konsumatore dhe rritjen e volumit të biznesit të sigurimeve në vendet në zhvillim. Ndër nismat me karakter global përmendet ajo e Solvency II, që synon të shqyrtojë dhe vendosë një regjim të kujdesshëm për siguruesit dhe risiguruesit jo vetëm në vendet e BE-së, por edhe më gjerë në mbarë botën.

Organizimi i kësaj konference synonte të siguronte një platformë unike të shkëmbimit të ideve, eksperiencave midis rregullatorëve, industrisë së sigurimeve dhe akademikëve për çështje të rëndësishme strategjike të mbikëqyrjes në sigurime, me qëllimin final strukturimin e një kornize rregullatore globale të sigurimeve.

Konferencë mbi sigurinë e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave

Në datën 25 shtator 2014 në Sofje, Bullgari, u organizua konferenca me temë "Siguria e informacionit dhe mbrojtja e të dhënave".

Konferenca u organizua nga *ICT Media (Information and Communications Technology Media)* në bashkëpunim me Shoqatën e Auditit dhe Kontrollit të Sistemeve të Informacionit (*ISACA, Information Systems Audit and Control Association*) mbështetur nga Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Shtetërore për Sigurinë Kombëtare, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Transportit, Teknologjisë dhe Komunikimeve të Bullgarisë.

Në hapjen zyrtare përshëndetën konferencën edhe Ministri i Mbrojtjes së Bullgarisë, Kryetari i Agjencisë Shtetërore për Sigurinë Kombëtare, përfaqësues nga Ministria e Transportit, Teknologjisë dhe Komunikimeve të Bullgarisë, si dhe drejtues të Helwett-Packard.

Diskutimet u fokusuan në rëndësinë e ruajtjes së informacionit, në rreziqet e reja me të cilat po përballen shtetet dhe kompanitë në fushën e sigurisë së informacionit. Në konferencë u diskutua edhe për aktivitetin e krimit të organizuar dhe rreziqet nga vjedhjet dhe abuzimi i të dhënave në botën digjitale. Konferenca pasqyroi eksperiencat të ndryshme në ruajtjen në mënyrë efektive të të dhënave dhe se si kompanitë aplikojnë strategji dhe plane për të luftuar rreziqet e abuzimit me këto të dhëna në të gjithë segmentet e ekonomisë.

Gjatë konferencës u bënë prezantime nga studiues dhe ekspertë të ndryshëm, të cilët prezantuan dhe trajtuan çështje si:

- » Siguria dhe privatësia;
- » Strategjia e ndjekur mbi rrjetin kompjuterik me monitorim të vazhdueshëm. (Zbulim-Analizim-Raportim);
- » Auditimi i sistemeve të informacionit për qëllime të sigurisë;
- » Parandalimi dhe investigimi i krimit kompjuterik;
- » Sfidat dhe si të mbrosh biznesin nga krimi kompjuterik;
- » Kërcënimet e mëdha nga rreziqet e vogla;
- » Siguria në dhënie dhe të dhënave dhe aksesit në telefonat inteligjent;
- » Sulmet kompjuterike dhe modeli i parandalimit të tyre.

Ky është viti i 13-të rradhazi i organizimit të konferencave të tilla, me tematikë mbi teknologjinë e informacionit, duke shërbyer si një forum i mirë për të ndarë eksperiencat midis ekspertëve të teknologjisë së informacionit si dhe përfaqësuesve të firmave globale nga më të njohurat në fushën e informatikës lidhur me rëndësinë e burimeve të informacionit dhe marrjen e masave më të përshtatshme për sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave.

Seminar mbi sistemet e pagesave dhe shlyerjes së letrave me vlerë

Banka Qendrore e Holandës zhvilloi në datat 22-25 shtator 2014, në Amsterdam, Holandë seminarin me temë “Sistemet e pagesave dhe shlyerjes së letrave me vlerë”.

Pjesëmarrësit në seminar ishin nga 34 vende të ndryshme të botës si Armeni, Brazil, Bullgari, Egjipt, Indonezi, Jordani, Kazakistan, Kenia, Kroaci, Maqedoni, Mali i Zi, Moldavi, Mongoli, Nepal, Rusi, Turqi, etj.

Disa nga çështjet kryesore që u trajtuan gjatë zhvillimit të këtij seminari kishin të bënim me:

- » Luftën ndaj krimit kibernetik dhe mënyrat e përgatitjes për kërcënimet nga ai;
- » Mbijetesën në botën gjithmonë e në ndryshim të sistemit të pagesave;
- » Risitë në sistemin e pagesave në tregun me pakicë të letrave me vlerë;
- » Rëndësinë e menaxhimit të likuiditetit, edhe në nivel global;
- » Ndërtimin në vazhdimësi të një biznesi të fortë dhe menaxhimin e krizave me të cilat ai po ndeshet.

Gjatë seminarit u bënë prezantime mbi rezultatet e kërkimit lidhur me mënyrën se si kryhen pagesat nga popullsia dhe cilat nga format e pagesave janë më donimuese në treg. Kjo lidhej edhe me monitorimin dhe të kuptuarin e sjelljes konsumatore sidomos e lidhur me sistemin bankar.

Studimi prezantoi edhe mënyrën se si *SEPA (Single Euro Payments Area)* influençoi në mënyrën e pagesave në Evropë. SEPA është një iniciativë e integruar e pagesës brenda Bashkimit Evropian për thjeshtëzimin e transfertave bankare të bëra në monedhën euro. Deri në shkurt të vitit 2014, SEPA përbëhej nga 28 vendet anëtare të Bashkimit Evropian, katër vendet anëtare të EFTA (Islanda, Litenshtejni, Norvegjia dhe Zvicra) si edhe Monako dhe San Marino.

Prezantimet lidheshin edhe me inovacionet në sistemin e pagesave, ku ndër të tjera u shpjegua edhe BITCOIN (një sistem pagese *online* i bazuar në një *software*) dhe transaksionet që mund të kryhen me të.

LAJMET NGA RAJONI

BOSNJE-HERCEGOVINË

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve boshnjake gjatë gjysmës së parë të vitit 2014 shënoi vlerën prej 144.8 milionë euro për primet e shkruara bruto, me rritje 9.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga ana tjetër, bilanci i kompanive të sigurimit është ndikuar ndjeshëm nga dëmet e shkaktuara nga përmbytjet katastrofike në këtë pranverë pasi vëllimi i dëmeve të paguara u rrit me rreth 27%, duke arritur në 61 milionë euro.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 21.8% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në vlerën 28 milionë euro. Sigurimi i Jetës aktualisht përbën rreth 19% të portofolit të tregut. Përveç sigurimit motorik, i cili pati ulje në 2% të primeve të shkruara bruto, të gjitha linjat e sigurimit të Jo-Jetës regjistruan një zhvillim pozitiv. Në tërësi, primet e shkruara bruto të sigurimit të Jo-Jetës u rritën me 6.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe arritën në vlerën 117 milionë euro. Rritja më e madhe është regjistruar në segmentin e sigurimit të pasurisë (13.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar), sidomos në linjën "dëmet ndaj pronës", për të cilën vëllimi i primeve të shkruara bruto u rrit me pothuajse 20%.

Megjithatë, segmenti i pronës pati një trefishim të vëllimit të dëmeve në krahasim me vitin e kaluar. Meqenëse pjesa veriore e vendit ishte goditur më keq nga përmbytjet, siguruesit banues në Republikën Serbe të Bosnje-Hercegovinës u prekën më shumë, duke patur kërkesa për pagesa dëmsh të pronës në shumën 9 milionë euro.

Sigurimi motorik vazhdon të sjellë 55% të primeve të shkruara bruto të tregut si edhe afro 55% të dëmeve të paguara. Sigurimi MTPL shënoi zhvillim pozitiv, ku vlera e primeve të shkruara bruto arriti në shumën 66 milionë euro (me 6.3% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar).



KROACI

www.xprimm.com

Siguruesit kroatë njoftuan për gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 një vëllim të primeve të shkruara bruto prej 618 milionë euro, me një rënie me 6.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sipas të dhënave të ofruara nga Byroja Kroate e Sigurimeve, sigurimi i Jetës pati një zhvillim pozitiv, me volumin e primeve të shkruara bruto që arriti në shumën 172.6 milion euro, me rritje pothuajse 4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në sigurimet e Jo-Jetës, sigurimi shëndetësor u rrit me 10%, sigurimi i kredisë me 22% dhe sigurimi i humbjes financiare me 3.2%, të cilët së bashku përbëjnë rreth 6% të tregut. Dy segmentet kryesore të Jo-Jetës, sigurimi i pronës dhe ai motorik, vazhduan të kenë zhvillim negativ, me volumin e primeve të shkruara bruto në rënie me respektivisht rreth 9% dhe 13% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

MAQEDONI

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Maqedoni në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 regjistroi një volum total të primeve të shkruara bruto prej 64.5 milionë euro, me një normë rritje vjetore 9.7%. Sigurimi i Jetës tregoi normën më të lartë të rritjes vjetore, prej rreth 20%, por ende mban një pjesë modeste në totalin e tregut, 9.7%.

Me përjashtim të klasave të "sigurimit motorik" dhe "zjarri dhe rreziqet shtesë" të gjitha linjat e sigurimeve të Jo-Jetës regjistruan një dinamikë pozitive. Sigurimi i "Dëmet në pronë" shënoi një rritje 36.6% në primin e shkruar bruto krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke zënë rreth 17% të portofolit të tregut. Sa i përket sigurimit "zjarri dhe rreziqet shtesë", volumi i primeve të shkruara bruto u ul me 0.6%, duke arritur në vlerën prej 4.35 milionë euro, ndërsa dëmet e paguara u rritën 147%, duke arritur vlerën prej 1.13 milionë euro.

Gjashtëmujori i parë i vitit 2014, për tregun e sigurimeve të Serbisë, përfundoi me një rritje 2.74% të volumit të primeve të shkruara bruto, duke arritur në vlerën 306.5 milionë euro. Ky rezultat reflekton edhe vlerësimin e monedhës vendase. (Rritja e normës së këmbimit të monedhës vendase ishte 4.19%). Faktori kryesor i rritjes së tregut ishin klasat e sigurimit të Jetës, të cilat shënuan një rritje 17.6% të volumit të primeve të shkruara bruto.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës arriti në vlerën 62.5 milionë euro, ndërsa dëmet e paguara për kontratat e Jetës arritën në 21 milionë dollarë, duke shënuar një rritje me rreth 38% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në sigurimin e Jo-Jetës, shumica e klasave regjistruan rënie në volumin e primeve të shkruara bruto. Përjashtimi më i dukshëm nga kjo tendencë negative ishte sigurimi i detyrueshëm, MTPL, i cili shënoi një rritje prej 5% në volumin e primeve të shkruara bruto, duke arritur në vlerën 87.4 milionë euro. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit është e parashikuar një rritje e mëtejshme në vëllimin e primeve të shkruara bruto, pasi Banka Kombëtare e Serbisë miratoi një rritje 45% të çmimit minimal të sigurimit TPL në Serbi, që hyri në fuqi me 1 korrik.

Sigurimi i pronës pati një rënie në 2% të volumit të primeve të shkruara bruto, pothuajse tërësisht e shkaktuar nga ulja 6% në volumin e primeve të shkruara bruto për klasat e sigurimit "zjarri dhe rreziqet shtesë". Në të njëjtën kohë, pas përmbytjeve të majit, dëmet e paguara për sigurimin e pronës u rritën me 45%. Megjithatë, në tërësi, siguroesit serbë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 paguan rreth 7 milionë euro dëme, shifër e cila ishte mjaft e ulët në krahasim me totalin e humbjeve të regjistruara në vend dhe duke pasqyruar kështu një mbulim të ulët të sigurimit të pronave.




STUDIME DHE BOTIME

Revista "Economist" nxjerr në treg një version të rishikuar të "Guidë për analizimin e kompanive" (*Guide to Analysing Companies*)

Në ditët e sotme, me një botë biznesi që lëviz me shpejtësi, në një situatë delikate të ndryshueshme dhe komplekse, nuk është e lehtë të kuptosh se sa e shëndetshme financiarisht është një kompani. Bilancet dhe pasqyrat e humbje-fitim mund të fshehin shpesh edhe problematika.

Botimi i kësaj guide është një ndihmë e madhe për të kuptuar dhe analizuar gjendjen e kompanive.

http://www.store.economist.com/Images/ECO/CMS/Analysing%20Companies%206th_Large.JPG



Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10, P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 / Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al / www.amf.gov.al